

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.Sh. nga P., për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së, i akuzuar sipas Propozim Akuzën së PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.3550/2012 e dt.04.07.2012, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 05.09.2016, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë Gjejrone Alaj të akuzuarit përfaqësueses të dëmtuarës KEK-ut tani KEDS, P. R., me datë 06.09.2016, mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 20.09.2016, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

R.SH., i biri i Sh. dhe nënës R., e vajzërisë A., i lindur më datë *data e lindjes...*, në fshatin H., Komuna e P., tani me vendbanim në P., me nr. personal: *numër personal...*, ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor sigurimi, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, baba i 4 (katër) fëmijëve, më parë i pa gjykuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së,

L I R O H E T N G A A K U Z A

Sepse:

Prej datës së pa vërtetuar e deri me datën 24.04.2012, në shtëpinë e tij e cila gjendet në ..., në P., me qëllim të përvetësimit të sendeve të huaja të luajtshme, vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm në mënyrë ilegale për plotësimin e nevojave të veta me energji elektrike, ka hequr njësinorin elektrik me nr.7069527, me qëllim të shmangies së pagesës së energjisë së shpenzuar elektrike, me ç'rast të dëmtuarës KEK-ut Distribucioni në Prishtinë i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 149.64€.

Me këtë kishte për të kryer veprën penale vjedhje neni 252 par.1 të KPK-së.

Për shkak se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalle, bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

E dëmtuara KEK (tani KEDS) Divizioni i rjetit në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Propozim Akuzën me Kërkesë për dhënien e Urdhrit Ndëshkimorë pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, PP.nr.3550/2012 e dt.04.07.2012, kundër të akuzuarit R.Sh. nga P., për shkak veprës penale vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së.

Gjykata lidhur çështje penale duke vepruar sipas kërkesës së prokurorisë me datë 16.04.2014, ka lëshuar Aktgjykim- Urdhër Ndëshkimor, kundër të cilit i akuzuari brenda afatit ligjor ka parashtruar kundërshtim.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimet gjyqësore, në praninë e prokurorit të Shtetit, të akuzuarit dhe të dëmtuarës KEK-ut tani KEDS.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, i akuzuari u deklarua i pa fajshëm për veprën penale për të cilat akuzohet.

Prokurori shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: Mbetem pranë aktakuzës i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Përfaqësuesja e të dëmtuarës KEDS në fjalën përfundimtare deklaroi: I bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe parashtroi kërkesë pasurore juridike në shumë prej 149.64 euro.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi, se nuk e pranon fajësinë nga se nuk është e vërtetë se kam kryer këtë vepër penale dhe kërkoi nga gjykata që ta shpall të pa fajshëm, dhe ta liroj nga kjo aktakuzë.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor ka administruar provat e propozuara nga Prokuroria e Shtetit me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale provat e propozuara gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara se nuk ka asnjë provë të vetme që vërtetojnë dyshimin e bazuar se i akuzuari ka kryer veprën penale.

Dëshmitari Xh. P. në shqyrtimin gjyqësor deklaroi, me datë 24.04.2012 kam qenë në punë në fshatin L. për ta ndërruar dhe hequr njësonin elektrik në një shtëpi i cili ka qenë i dëmtuar e i cili

ka qenë në emër të R.Sh., nga viti 2010 që e kontrolloj atë teren e këndeje R.Sh. nuk ka jetuar në atë fshat, por ka banuar te banesat përballë emergjencës në P..

Dëshmitari R. S. në shqyrtimin gjyqësor lidhur me rastin veç tjerash deklaroi, në mëngjes i kemi marr udhëzimet për ndërrimin dhe heqjen e njësorit elektrik, mirëpo nuk i kujtohet asgjë dhe nuk e njih fare R.Sh..

Dëshmitari F. B. në shqyrtimin gjyqësor deklaroi, se jeton në rrugën “...” në shtëpi e cila është dy kat një kat imi dhe një i vllaut i cili jeton në Itali, ka një njësor elektrik, nuk e di pse vjen në emër të R.Sh. të cilin nuk e njohë e as që e kamë pa ndonjëherë dhe nuk ka jetuar në atë shtëpi.

Nga vërtetimi i datës 24.04.2012, rrjedha e njësorit elektrik të datës 24.05.2012, shkresa për të dhënat e konsumatorit të datës 24.05.2012, fatura me nr.03-012 e datës 31.05.2012, si dhe fatura DPR 1 DHP11124 të datës 31.05.2012, nuk janë vërtetuar elementet e veprës penale se vërtet i akuzuari R.Sh. ka jetuar në atë shtëpi në rrugën “...” dhe ka ndërmarr veprime në drejtim të kryerjes së kësaj veprë penale për të cilën është akuzuar.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të datës 05.09.2016 e ka refuzuar propozimin e përfaqësueses së të dëmtuarës KEDS, për vërtetimin e pronësisë dhe dëgjimin e N. F. dhe Xh. P., si dhe propozimin e prokurorisë që të sillet fatura e prezantuar në emër të R.Sh., për arsye se këto propozime janë bërë vetëm sa për ta zvarritur procedurën penale, për faktin se objekt i shqyrtimit gjyqësor ka qenë propozim akuza e prokurorisë kundër të akuzuarit të lartcekur për veprë penale nga neni 252 par.1 të KPK-së, propozimi për dëgjimin e N. F. dhe Xh. P. gjykata e ka vlerësuar duke e refuzuar si të pa bazuar, nga se Xh. P. është dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor, si dhe propozimi i prokurorisë për sjellje të faturës është krejtësisht e pa nevojshme shtyrja e shqyrtimit gjyqësor për faktin se nuk ka qenë kontestuese fatura e shtëpisë që figuron në emër të R.Sh., mirëpo nuk është arrit të vërtetohet se a ka jetuar në shtëpinë në rrugën “...” dhe nëse eventualisht ka jetuar periudha kohore kur ka banuar në mënyrë që të vërtetohet koha e kryerjes së veprës penale.

Nga deklaratat e dëshmitarëve të propozuar Xh. P., R. S. si dhe dëshmitari F. B. të cilat dëshmi ndërlidhen njëra me tjetrën nuk është vërtetuar se i akuzuari ka banuar në shtëpinë në rrugën “...” në fshatin L., Komuna e P..

Gjykata duke pasur në konsideratë nenin 7 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se gjykata, prokurori i shtetit, dhe policia janë të detyruar që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve të ligjshme, dhe me përkujdesje të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit dhe në favor të tij, dhe bazuar në nenin 361 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, dhe detyrohet të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të nxirret përfundim nëse fakti konkret është provuar, si dhe bazuar në nenin 3 par. 2 të KPPRK-së, është përcaktuar se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të pandehurit. Andaj bazuar në këto nene të kodit të procedurës penale dhe në provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mungesë të provave në drejtim të fajësisë gjykata ka marrë aktgjykim lirues në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar. 1.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr në bazë të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.3 të KPPRK-së

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.789/2012 të dt. 20.09.2016

Sekretare juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.